

**Politikat e Privatesise dhe Rregullorja e Faqes se Internetit [www.puna.gov.al](http://www.puna.gov.al)**

**Me hyrjen tuaj ne kete faqe internet, ju pranoni se keni lexuar dhe pranuar kushtet e meposhtme:**

Kjo faqe ku keni hyrë, [www.puna.gov.al](http://www.puna.gov.al) është faqja zyrtare e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Në këtë faqe përdoruesi mund të hasë në forma apo formularë të ndryshëm, aplikimi (psh. Aplikimet për punëkërkuës, aplikimet për punëdhënës , lancimin e një vendi të lirë pune nga punëdhënësi etj). Në fusha të ndryshme të këtyre formateve apo formularëve mund të lind nevoja për të futur të dhëna personale. SHKP siguron çdo përdorues se të dhënat që mbërrijnë në bazën e të dhënave të saj i siguron me sistemin e sigurisë më të lartë dhe njëkohësisht është e përkushtuar të zbatojë rigorozisht të gjithë kuadrin ligjor në mbrojtje dhe respektim të çdo veprimi të lidhur me të dhënat e përdoruesve, ashtu sic edhe përcaktohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji në fuqi (Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012) “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe aktet nënligjore në plotësim.

Gjithashtu përdoruesi pohon vertetesine dhe sakesine e te gjithe te dhenat e plotesuara prej tij ne format apo formularet e ndryshem. Me plotesimin e cdo forme apo formulari dhe shtypjen e butonit te vazhdimit, perdoruesi pranon te drejten SHKP-se per perdorimin e brendshem, vetem per qellimin e kerkuar nga perdoruesi, te informacioneve te plotesuara si dhe procesimin e metejshem te tyre nga ana e SHKP-se. Bazuar ne ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 perdoruesi, nepermjet nje kerkese, ka te drejte te kerkoje te shohe te dhenat e tij personale dhene vullnetarisht, apo te kerkoje korrigjimin e tyre.